

Në bazë të nenit 6 paragrafi 1 alineja 6, neni 18 paragrafi 1 alineja 8 dhe neni 20 paragrafi 1 alineja 11, në lidhje me nenin 6 paragrafi 2 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14), si dhe neni 15 paragrafi 1 alineja 7 nga Rregullorja e punës së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale nr. 01-4351/1 nga data 29.08.2014, në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë 02-6553/4 nga data 27.12.2014, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale në mbledhjen e saj të 24-të, të realizuar më datë 27.12.2014, miratoi:

## **DORACAK**

**për mënyrën e matjes së shikueshmërisë dhe dëgjueshmërisë së programeve, respektivisht shërbimeve programore të radiodifuzerëve në Republikën e Maqedonisë**

### **I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Lënda e doracakut**

1. Me këtë doracak rregullohet mënyra e matjes së shikueshmërisë dhe dëgjueshmërisë së programeve, respektivisht shërbimeve programore të radiodifuzerëve në Republikën e Maqedonisë

#### **Qëllimi i Doracakut**

2. Qëllimi i doracakut është sigurimi i një sistemi të vlefshëm dhe të besueshëm për matjen e shikueshmërisë dhe dëgjueshmërisë së programeve, respektivisht shërbimeve programore të radiodifuzerëve në Republikën e Maqedonisë.

### **II DISPOZITAT E VEÇANTA**

**MATJA E SHIKUESHMËRISË SË STACIONEVE TELEVIZIVE QË EMETOJNË  
PROGRAM NË NIVEL SHTETËROR PËRMES MULTIPLEKSIT DIGJITAL TERESTRIAL  
DHE NDËRMARRJES PUBLIKE TË RADIODIFUZIONIT RADIOTELEVISIONI I  
MAQEDONISË**

#### **Këshilli iniciues**

3. Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale do të marrë iniciativë për formimin e Këshillit iniciues i cili do të realizoj përgatitjet për themelimin e Komitetit të Maqedonisë për matjen e publikut (në tekstin e mëtejme Komitetin).

**3.1.** Këshilli i Agjencisë me propozim të Drejtorit, miraton aktvendim për iniciimin e iniciativës për formimin e Këshillit iniciues.

**3.2.** Këshilli iniciues do të përbëhet nga: një përfaqësues i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, ndërmarrja publike e radiodifuzionit Radiotelevizioni i Maqedonisë, Alsat-M SHPK Shkup, SHTR ALFA TV SHPKNJP Shkup, KANAL 5 SHPKNJP Shkup, SITEL dhe TELMA SHPKNJP Shkup, Asociacioni i publikuesve dhe dy përfaqësues nga agjencitë a marketingut, anëtare të Asociacionit të Maqedonisë të agjencive për marketing.

**3.3.** Cdo anëtar i Këshillit iniciues është i obliguar që të emëroj përfaqësues të saj për pjesëmarrje në Këshillin iniciues, në afat prej tre (tre) ditëve nga dita e pranimit të vendimit nga pika 3.1. Përfaqësuesi i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, mandati i të cilit zgjatë 2 (dy) vjet, emërohet nga Këshilli i Agjencisë me propozim të drejtorit.

**3.4.** Detyra themelore e Këshillit iniciues është që të përpiloj draft – aktet për punën e Komitetit dhe të bëjë regjistrimin e Komitetit në Regjistrin tregtar dhe regjistrin e personave tjerë juridik që i udhëheq Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë, më së voni deri më 01.02.2015. Forma organizative e Komitetit përcaktohet nga Këshilli iniciues, ndërsa miratohet nga Drejtori i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

Personin e autorizuar të Komitetit e emërojnë anëtarët me të drejtë vote. Nëse personi i autorizuar i Komitetit nuk emërohet më së voni deri më 01.02.2015, Drejtori i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale do të emëroj person ushtrues detyre, i cili do ta kryej këtë funksion deri në emërimin e personit të autorizuar nga ana e anëtarëve të Komitetit me të drejtë vote.

### **Komiteti i Maqedonisë për matjen e publikut**

**4.** Komiteti formohet me akt që miratohet nga të gjithë anëtarët e tij me të drejtë vote. Forma dhe përmbajtja e këtij akti në draft – formë përcaktohet nga Këshilli iniciues. Akti për formimin dhe statuti i Komitetit miratohen nga drejtori i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

**5.** Anëtarë të Komitetit janë:

**5.1.** Ndërmarrja publike e radiodifuzionit Radiotelevizioni i Maqedonisë,

**5.2.** Alsat-M SHPK Shkup,

**5.3.** SHTR ALFA TV SHPKNJP Shkup,

**5.4.** KANAL 5 SHPK Shkup,

**5.5.** SITEL,

**5.6.** TELMA SHPKNJP Shkup,

**5.7.** Dy agjenci të marketingut, të propozuara nga Asociacioni i Maqedonisë i agjencive të marketingut,

**5.8.** Asociacioni i publikuesve dhe

**5.9.** Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, pa të drejtë vote.

**6.** Komiteti do ti miratojë vendimet sipas parimit 1 (një) anëtar = 1(një) votë, me përjashtim të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, e cila nuk ka të drejtë vote. Për miratimin e vendimit, nevojitet pëlqim prej së paku 4(katër) stacione televizive.

**7.** Detyrë themelore e Komitetit është që ti koordinojë matjet e shikueshmërisë së programeve, respektivisht shërbimeve programore të radiodifuzerëve që emetojnë program televiziv në nivel shtetëror përmes multipleksit digjital terestrial dhe të Ndërmarrjes publike të radiodifuzionit Radiotelevizioni i Maqedonisë.

**8.** Gjatë realizimit të detyrës themelore nga pika 7 e këtij Doracak, Komiteti i kryen këto detyra:

**8.1.** shpall konkurs për përzgjedhjen e agjencisë hulumtuese që do ta realizojë hulumtimin në bazë të së cilës do të merren informatat për strukturën dhe profilin e amvisërive në Republikën e Maqedonisë, e që do të jetë bazë për krijimin e panelit, më së voni deri më 01.03.2015;

**8.2.** shpall konkurs për përzgjedhjen e agjencisë hulumtuese që do të realizojë matjet e shikueshmërisë së programeve, respektivisht shërbimeve programore të radiodifuzerëve që emetojnë program televiziv në nivel shtetëror përmes multipleksit digjital terestrial dhe të Ndërmarrjes publike të radiodifuzionit Radiotelevizioni i Maqedonisë, më së voni në afat prej 4 (katër) muajve nga dita e shpalljes së konkursit nga pika 8.1;

**8.3.** kryen përzgjedhjen e agjencisë hulumtuese;

**8.4.** e mbikëqyr realizimin e projektit dhe i përcakton kushtet për qasjen deri te të dhënat;

**8.5.** përcakton standarde minimale ndaj të cilave duhet të përmbahet agjencia e zgjedhur për hulumtim, e që kanë të bëjnë me:

**8.5.1.** standardet për sigurimin e kualitetit;

**8.5.2.** standardet për sigurimin e transparencës.

## **Këshilli drejtues i Komitetit**

**9.** Këshillin drejtues të Komitetit e përbëjnë përfaqësues të këshillave të Komitetit – nga një përfaqësues prej çdo anëtari.

Përfaqësuesit e emëruar duhet të jenë në nivel adekuat të hierarkisë të personi juridik që e përfaqësojnë, në kuptim të asaj që ata të mund që vet të sjellin vendime, me qëllim që të sigurohet miratimi efektiv i vendimeve të Komitetit.

Këshilli drejtues mbledhet sipas nevojës, më së paku një herë në tre muaj.

## **Përzgjedhja e agjencisë hulumtuese dhe realizimi i hulumtimit**

**10.** Shpalljen për përzgjedhjen e agjencisë hulumtuese që do të realizojë matjet e shikueshmërisë së programeve, respektivisht shërbimeve programore të radiodifuzerëve që emetojnë program televiziv në nivel shtetëror përmes multipleksit digjital terestrial dhe të Ndërmarrjes publike të radiodifuzionit Radiotelevizioni i Maqedonisë, e publikon Komiteti më së voni në afat prej 4 (katër) muajve nga dita e shpalljes së konkursit nga pika 8.1;

**11.** Përzgjedhjen e agjencisë hulumtuese që do të realizojë matjet e shikueshmërisë së programeve, respektivisht shërbimeve programore të radiodifuzerëve që emetojnë program televiziv në nivel shtetëror përmes multipleksit digjital terestrial dhe të Ndërmarrjes publike të radiodifuzionit Radiotelevizioni i Maqedonisë, e publikon Komiteti ndërsa e miraton drejtori i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

**12.** Të drejtë për pjesëmarrje në konkurs kanë agjencitë hulumtuese që kanë përvojë në matjen e shikueshmërisë më së paku 5 (pesë) vite, por jo më pak se 3 (tre) muaj nga vendet e Bashkimit Evropian ose të Organizatës për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik (OECD).

**13.** Kriteret për përzgjedhjen e agjencisë hulumtuese që do të realizojë matjet e shikueshmërisë së programeve, respektivisht shërbimeve programore të radiodifuzerëve që emetojnë program televiziv në nivel shtetëror përmes multipleksit digjital terestrial dhe të Ndërmarrjes publike të radiodifuzionit Radiotelevizioni i Maqedonisë, e përcakton Komiteti me një akt të veçantë.

Ofruesit duhet të dorëzojnë deklaratë se do të sigurojnë standardet minimale të përcaktuara nga ana e Komitetit.

**14.** Marrëveshjen me Agjencinë hulumtuese që do të realizojë matjet e shikueshmërisë së programeve, respektivisht shërbimeve programore të radiodifuzerëve që emetojnë program televiziv në nivel shtetëror përmes multipleksit digjital terestrial dhe të Ndërmarrjes publike të

radiodifuzionit Radiotelevizioni i Maqedonisë, e nënshkruan Komiteti ndërsa e miraton drejtori i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.

Marrëveshja lidhet për një periudhë prej 5 (pesë) viteve.

Pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshje (në formë të anekseve ndaj Marrëveshjeve) janë marrëveshjet individuale komerciale të anëtarëve të Komitetit, të përcaktuara në pikën 15 të këtij Doracaku.

**15.** Shfrytëzuesit e të dhënave nga matjet e publikut (përfshirë edhe anëtarët e Komitetit) nënshkruajnë marrëveshje individuale komerciale me agjencinë hulumtuese, në të cilën përcaktohet se cilat të dhëna nga matja e publikut do të përdor secili nga ata dhe me çfarë kompensimi financiar. Marrëveshjet e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele dhe të Ndërmarrjes publike të radiodifuzionit Radiotelevizioni i Maqedonisë do të lidhen në pajtim me Ligjin për furnizime publike.

Agjencia hulumtuese është e obliguar që të përcaktojë kritere të qarta dhe transparente sipas të cilave do të përcaktohet kompensimi që do ta paguajnë shfrytëzuesit për përdorimin e të dhënave.

**16.** Të dhënat e siguruara nga agjencia e përzgjedhur e hulumtimit janë të dhëna zyrtare për matjen e publikut televiziv në Republikën e Maqedonisë.

**17.** Anëtarët e Komitetit do të kenë kontroll në indikatorët kryesor për kualitet të operacioneve që do të definohen në marrëveshje në nivel të shërbimeve që do ti sigurojë agjencia hulumtuese. Me kërkesë të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele do të mundësohet qasje deri te të dhënat në nivel individual për analiza të mëtejshme, me anonimitet të garantuar të amvisërive në panel.

**18.** Nëse dikush prej shfrytëzuesve të shërbimeve të agjencisë së përzgjedhur konsideron se rezultatet e matjes së publikut televiziv janë jo të sakta dhe të pavlefshme, do të inicioi angazhimin e një shtëpie të pavarur të konsultimit/revizionit me përvojë ndërkombëtare në zbatimin e revizionit të matjeve të publikut televiziv.

Aktivitetet që do të dalin nga konstatimet e revizionit të realizuar do të konstatohen në marrëveshjen e nënshkruar në mes të Komitetit dhe agjencisë hulumtuese.

**MATJA E SHIKUESHMËRISË SË STACIONEVE TELEVIZIVE QË EMETOJNË  
PROGRAM NË NIVEL SHTETËROR PËRMES SATELITIT OSE PËRMES RRJETIT  
PUBLIK TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK DHE TË STACIONEVE TELEVIZIVE QË  
EMETOJNË PROGRAM NË NIVEL RAJONAL DHE LOKAL**

19. Të dhënat për shikueshmërinë e stacioneve televizive që emetojnë program në nivel shtetëror përmes satelitit ose përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik dhe të stacioneve televizive që emetojnë program në nivel rajonal dhe lokal, Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale do ti sigurojë përmes hulumtimeve të rregullta për publikun, të cilat do ti realizojë agjencia hulumtuese e përzgjedhur në pajtim me Ligjin për furnizime publike.

**MATJA E DËGJUESHMËRISË SË RADIOSTACIONEVE**

20. Të dhënat për dëgjueshmërinë e radiostacioneve Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale do ti sigurojë përmes hulumtimeve të rregullta të publikut, që do ti realizojë agjencia hulumtuese e përzgjedhur në pajtim me Ligjin për furnizime publike.

**II. DISPOZITAT PËRMBYLLËSE**

21. Ky doracak hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në “Gazetë zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

**Nr. 01-6582/1  
27.12.2014  
Shkup**

**Agjencia për shërbime  
mediatike audio dhe audiovizuale  
Kryetar i Këshillit**

**Llazo Petrushevski, d.v.**